

SHËNIMET SHPJEGUESE

1. TË PËRGJITHSHME

1.1. Informacion në lidhje me themelimin

1.1.1. Shoqëria **BRUNES SHPK** është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 27/02/2019 dhe është regjistruar ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit ne regjistrin e shoqërive tregtare ne 27/02/2019. Veprimtaria e shoqërisë rregullohet sipas dispozitave përkatëse te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", nga statuti i saj dhe legjislacioni shqipëtar ne fuqi për tatimet dhe taksat.

1.2. Objekti

1.2.1. Tregtimin me shumice e pakice te materialeve te ndërtimit, qeramike dhe hidrosanitare, hidrotermoizoluese, pllaka për shtrim veshjesh, shitblerje e objekteve te ndërtimit, punime duralumini e punime pllaka gipsi etj. Shitblerje me shumice e pakice, eksport import te mallrave te ndryshëm industrial, ushqimor, bar bufe, konfeksione, tekstile, pajisje elektroshtëpiake, artikuj mobilierie dhe mobilime zyresh, artikuj kancelarie, karta telefonike. Ekspozimi i mallrave dhe vinoteka. Bar-restorant. Prodhim dhe tregtim te botimeve periodike (revistave etj.) ne funksion te veprimtarisë për dekorime ambientesh, degustime etj. Shitja, blerja, dhënia me qira e pasurive te paluajtshme. Ndërmjetësim për blerje, shitje e dhënie me qira te pasurive te paluajtshme. Investime në ndërtim për objektet e veta, investime ne fushën e turizmit (hoteleri, porte, bar restorante etj. Menaxhimi i hoteleve, porteve, bar restorante, qendra tregtare, dhënie me qira. Zhvillim te aktivitetit tregtar dhe komercial ne supermarketete, hotele, dyqane, bar-restorant, piceri. Hapje e qendrave dhe komplekseve sportive, salla lojërash, qendra kurative, aktiviteti turistik etj. Shërbim transport ndërkombëtar dhe kombëtar për vete dhe për pale te trete . Import-eksport dhe tregtim me shumice e pakice te makinave dhe autoveturave të të gjitha llojeve dhe tonazheve, dhënia me qira e tyre , mirëmbajtje , pjese këmbimi etj. Sipërmarrje dhe realizimi i punëve të ndërmjetësimit, agjencisë dhe transportit në interes të vetë shoqërisë ose të palëve të treta porositëse. Si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptare ne fuqi. Punime ndërtimi si muratura, suvatime, nivelime, shtrim pllakash, instalim dhe shtrim parketi, instalime elektrike, hidroizolime dhe hidraulike, parket, karpentieri, punime te ndryshme ndërtimi dhe nënkontraktorë etj. Rikonstruksione për objektet e veta dhe për te trete për godina banimi, pallate te ndryshme, ndërtime civile dhe ekonomike për çfarëdolloj objekti, veshje fasadash te godinave te ndryshme. Furnizimi me karburant i makinave. Montim dhe çmontim te mobiljeve, ekspozitorëve, mjeteve te palestrës si dhe çdo produkt qe tregon shoqëria për llogari të klientëve dhe të tretëve.

1.3. Të dhëna të tjera të përgjithshme

1.3.1. Certifikimi tatimor

1.3.1.1. K37125203H

1.3.2. Forma juridike e shoqërisë

1.3.2.1. Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar

1.3.3. Adresa e selisë

1.3.3.1. Durrës Xhafzotaj Godinë dy-katëshe (SHOWROOM dhe Magazinë) përballe Komunës Xhafzotaj, Kati 1, Zona Kadastrale 2574, Nr. Pasurie 163/42, Stacioni Zooteknik Xhafzotaj

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL

2.1. Bazat e përgatitjes**2.1.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

2.1.1.1. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2. Bazat e matjes

2.2.1. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së. Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe, nëse ka të tilla.

2.3. Biznesi në vijimësi

2.3.1. Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

2.4.1. Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

2.5.1. Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

3. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA**3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

3.1.1. Një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive nga data 1 janar 2020 por ato nuk kanë patur ndryshime në pasqyrat financiare të shoqërisë. Këto ndryshime janë paraqitur më poshtë:

3.1.1.1. SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021)

3.1.1.2. • Reforma e standardit të normës së interesit (IBOR) - ndryshimet në fazën 2 të SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 (lëshuar më 27 gusht 2020 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).

3.2. Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të papërvetësuara


3.2.1. Një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Shoqëria ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Këto ndryshime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të shoqërisë, janë paraqitur më poshtë:

3.2.1.1. Ndryshimet në SNRF 3 për disa referenca nga ndryshimet e Kuadrit Konceptual (në fuqi më 1 janar 2022).

3.2.1.2. Ndryshimet në SNK 37 "Provizionet, aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara" (në fuqi më 1 janar 2022).

3.2.1.3. Ndryshimet në SNK 16 "aktivet afatgjata materiale" (në fuqi më 1 janar 2022).

3.2.1.4. Ndryshimet në SNA 1 në klasifikime (në fuqi më 1 janar 2023).



BRUNES SHPK

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

- 3.2.1.5. Ndryshimet në shënimet për politikat kontabël (në fuqi më 1 janar 2023).
- 3.2.1.6. Ndryshimet në SNK 18 "Politikat kontabël, vlerësimet dhe gabimet" (në fuqi më 1 janar 2023).
- 3.2.1.7. SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).

4. POLITIKAT KONTABËL

4.1. Politikat kontabël

4.1.1. Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në menyrë konsistente gjatë periudhës për të cilën janë përgatitur këto pasqyra financiare të ndërmjetme, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

4.2. Transaksionet në monedhë të huaj

4.2.1. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare të paraqitura në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit të përdorura në konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë:

Kursi i këmbimit	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
EUR/ LEK	114.23	120.76
USD / LEK	107.05	100.54

4.3. Instrumentet financiarë

4.3.1. Instrumentet financiare – njohja fillestare.

4.3.1.1. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlerë e dejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

4.3.2. Aktive financiare — klasifikimi dhe matjet pasuese — kategoritë e matjes.

4.3.2.1. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

4.3.3. Aktive financiare — klasifikimi dhe matjet pasuese — modeli i biznesit.

- 4.3.3.1. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i kompanisë është:
- 4.3.3.1.1. vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose
- 4.3.3.1.2. për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjetesh monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose
- 4.3.3.1.3. nëse asnjë nga (4.3.3.1.1) dhe (4.3.3.1.2) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.
- 4.3.4. Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që kompania ndërmerret për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.
- 4.3.5. *Aktivitetet financiare — klasifikimi dhe matjet pasuese — karakteristikat e flukseve monetare.*
- 4.3.5.1. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për t'i shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas.
- 4.3.6. *Aktivitetet financiare — pakësimi i vlerës*
- 4.3.6.1. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivitetet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.
- 4.3.7. *Aktivitetet financiare - çregjistrimi.*
- 4.3.7.1. Shoqëria çregjistron aktivitetet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare në ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitetit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk mban thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala

tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aset në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

4.3.8. Detyrimet financiare — kategoritë e matjes

4.3.8.1. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

4.3.9. Detyrimet financiare — çregjistrimi

4.3.9.1. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (d.m.th.. kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

4.3.10. Kompensimi i instrumenteve financiare

4.3.10.1. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit

4.3.10.1.1. nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe

4.3.10.1.2. duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme:

4.3.10.1.2.1. në rrjedhën normale të biznesit,

4.3.10.1.2.2. në rast vonese të pagesave dhe

4.3.10.1.2.3. në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

4.3.10.2. Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përberë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të kompanisë maten me koston e amortizuar.

4.3.10.3. Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbetet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshkohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit. Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

4.3.11. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

4.3.11.1. Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

4.3.12. Llogari të arkëtueshme

4.3.12.1. Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionin për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori

të falimentojës ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

4.3.13. Llogaritë e pagueshme

4.3.13.1. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.3.14. Huatë

4.3.14.1. Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

4.3.14.2. Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së koston të amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skonton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

4.3.15. Vlera e drejtë

4.3.15.1. Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

4.3.16. Të tjera

4.3.16.1. Instrumente të tjerë jo-derivativë maten me koston të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

4.3.17. Kapitali themeltar

4.3.17.1. Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

4.3.18. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

4.3.18.1. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me koston të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me koston të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.4. Inventarët

4.4.1. Inventarët regjistrohen në kontabilitet me koston. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në koston përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.5. Aktivet Afatgjata Materiale

4.5.1.Njohja dhe matja

4.5.1.1. Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e montimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.5.2.Kostot e mëpasshme

4.5.2.1. Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

4.5.3.Amortizimi

4.5.3.1. Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

4.5.3.2. Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2022 dhe 2021 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Toka	Nuk aplikohet	0%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Instalime teknike	Vlera e mbetur	20%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe orëndi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike përshirë Software	Vlera e mbetur	25%

4.5.4.Çregjistrimi

4.5.4.1. Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.6. Të ardhurat

4.6.1. Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat

maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysht shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

4.7.1. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.8. Qiratë

4.8.1. Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

4.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

4.9.1. Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.10. Tatimi mbi fitimin

4.10.1. Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 15% (2020: 15%). Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

4.11. Fondet për pensione

4.11.1. Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4.12. Transaksionet me palët e lidhura

4.12.1. Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe menaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.13. Provizionet

4.13.1. Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.14. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

4.14.1. Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.15. Investimet e tjera afatgjata

4.15.1. Aktive afatgjata të investuara, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qiratë dhe/ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe përfitimet nga pronësia transferohen te shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivet afatgjata të investuara maten me modelin e kostos.

4.16. Pjesëmarrjet në shoqëri të tjera

4.16.1. Pjesëmarrjet në shoqëri, përfshijnë njësitë ekonomike të strukturuar, që Shoqëria kontrollon sepse Shoqëria:

4.16.1.1. i ka fuqi për të drejtuar veprimtaritë përkatëse të filialit që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në fitimet e tyre,

4.16.1.2. ka ekspozim ose të drejta për fitime të ndryshueshme nga përfshirja e saj me investimin,

4.16.1.3. ka aftësinë për të përdorur fuqinë e tij mbi të investuarit që ndikojnë në shumën e fitimeve të investitorit.

4.16.2. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave thelbësore, duke përfshirë të drejtat votuese potenciale, konsiderohen kur vlerësohet nëse shoqëria ka fuqi mbi një njësi tjetër ekonomike. Për një e drejtë që të jetë thelbësore, mbajtësi duhet të ketë një aftësi praktike për të ushtruar këtë të drejtë, kur duhet të merren vendime për drejtimin e aktiviteteve përkatëse të filialit. Shoqëria mund të ketë fuqi mbi një filial edhe kur ajo mban më pak se shumicën e të drejtës së votave të një filiali. Në një rast të tillë, Shoqëria vlerëson madhësinë e të drejtave të votës në raport me madhësinë dhe shpërndarjen e zotërimeve të mbajtësve të tjerë të votave për të përcaktuar nëse de-facto ka kontroll mbi filialin. Të drejtat mbrojtëse të investitorëve të tjerë, të tilla si ato që kanë të bëjnë me ndryshime thelbësore të aktiviteteve të filialit ose të tilla që zbatohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme nuk e pengojnë shoqërinë të kontrollojë filialin. Filialet konsolidohen nga data në të cilën kontrolli i transferohet Shoqërisë (data e blerjes) dhe pushojnë së konsoliduari në datën në të cilën kontrolli humbet. Investimet në filiale në këto pasqyra financiare individuale të veçanta maten me kosto.

4.17. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

BRUNES SHPK

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4.17.1. Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

5. GJYKIME DHE VLERËSIME KRITIKE TË KONTABILITETIT

5.1. Vlerësimet dhe gjykimet

5.1.1. Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

5.2. Tatimi mbi fitimin

5.2.1. Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurtë. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatim fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

5.3. Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale

5.3.1. Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

5.4. Vlerësimi i modelit të biznesit

5.4.1. Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Llogaritë e arkëtueshme të kompanisë përfshijnë vetëm një dalje të mjeteve monetare, pagesën e vlerës që rezultojnë nga transaksioni në lidhje me SNRF 15, i cili konsiderohet të jetë kryesor. Prandaj, daljet e mjeteve monetare nga llogaritë e arkëtueshme janë në përputhje me modelin e biznesit pavarësisht komponentit të interesit duke qenë zero.

5.5. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

5.5.1. Situata pandemike COVID-19 ka shtuar pasigurinë në lidhje me vlerësimin e efekteve tregtare dhe financiare. Gjithsesi, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

6. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

6.1. Aktivet afatgjata materiale përbëhen si më poshtë:

Përshkrimi	Impiante dhe makineri	Te tjera instalime dhe pajisje	Toka dhe ndërtesa	Total

BRUNES SHPK*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

Kosto Historike				
Gjendja 01/01/2021	86,194,666	226,279,835	747,147,877	1,059,622,378
Shtesa	15,295,856	37,902,962	68,195,216	121,394,034
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja 31/12/2021	101,490,522	264,182,797	815,343,093	1,181,016,412
Shtesa	147,731,946	216,005,003	242,720,501	706,357,450
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja 31/12/2022	249,222,468	480,187,800	1,058,063,594	1,887,373,862
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja 01/01/2021	(25,701,224)	(83,796,285)	(42,654,717)	(152,152,226)
Shtesa	(13,410,586)	(11,635,027)	(5,665,167)	(30,710,780)
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja 31/12/2021	(39,111,810)	(95,431,312)	(48,319,884)	(182,863,007)
Shtesa	(72,022,131)	(186,709,706)	(201,948,742)	(460,680,579)
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja 31/12/2022	(111,133,941)	(282,141,018)	(250,268,626)	(643,543,586)
Gjendje neto 31/12/2021	62,378,712	168,751,484	767,023,209	998,153,405
Gjendje neto 31/12/2022	186,843,756	249,191,552	807,794,968	1,243,830,276

7. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

7.1. Aktivet afatgjata jomateriale paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

Përshkrimi	Koncesione, patenta, licenca, makra tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme	Total
Kosto Historike		
Gjendja 01/01/2021	4,002,530	4,002,530
Shtesa	314,496	314,496
Pakësime	-	-
Gjendja 31/12/2021	4,317,026	4,317,026
Shtesa	1,031,765	1,031,765
Pakësime	-	-
Gjendja 31/12/2022	5,348,791	5,348,791
Amortizimi i akumuluar		
Gjendja 01/01/2021	(874,457)	(874,457)
Shtesa	(469,211)	(469,211)



BRUNES SHPK*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

Pakësime	-	-
Gjendja 31/12/2021	(1,343,668)	(1,343,668)
Shtesa	(600,768)	(600,768)
Pakësime	-	-
Gjendja 31/12/2022	(1,944,436)	(1,944,436)
Gjendje neto 31/12/2021	2,973,358	2,973,358
Gjendje neto 31/12/2022	3,404,355	3,404,355

8. AKTIVE ME TË DREJTË PËRDORIMI

8.1. Aktivet me të drejtë përdorimi paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

Përshkrimi	Aktive Afatgjata në Përdorim	Total
Kosto Historike		
Gjendja 01/01/2021	385,389,664	385,389,664
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja 31/12/2021	385,389,664	385,389,664
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja 31/12/2022	385,389,664	385,389,664
Amortizimi i akumuluar		
Gjendja 01/01/2021	310,123,771	310,123,771
Shtesa	(76,293,631)	(76,293,631)
Pakësime	-	-
Gjendja 31/12/2021	233,830,140	233,830,140
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja 31/12/2022	233,830,140	233,830,140
Gjendje neto 31/12/2021	233,830,140	233,830,140
Gjendje neto 31/12/2022	233,830,140	233,830,140

9. HUA AFATGJATA DHE SHPENZIME TË SHTYRA

9.1. Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
------------	------------------	------------------



BRUNES SHPK*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

DEKOLL	21,464,864.00	57,867,033.99
ALDOCH	6,140,000.00	6,140,000.00
KIKA CERAMICA	1,858,808.00	1,858,808.40
LOBBY HOME	235,830,592.00	230,407,302.09
MARINA RESIDENCES VLORE	5,434,875.00	
MARINA DI VALONA	12,126,000.00	
Total	282,855,139.00	296,273,144.48

9.2. Shpenzimet e shtyra lidhen me diferencat e përkohshme në lidhje me njohjen e detyrimeve për qiratë financiare më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 dhe detajohen si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Shpenzime të shtyra	19,104,558	19,104,558
Total	19,104,558	19,104,558

10. INVENTARI

10.1. Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Materiale te para	9,678,809	9,678,809
Mallra për shitje	2,335,457,732	2,375,101,722
Te tjera inventarë	(21,961,378)	(50)
Total	2,323,175,163	1,665,881,223

11. LLOGARI TE ARKËTUESHME TREGTARE DHE LLOGARI TE TJERA TE ARKËTUESHME

11.1. Llogaritë e arkëtueshme tregtare detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Parapagime te dhëna	3,157,248,952	2,486,558,712
Klientë	2,113,585,477	1,056,271,401
Te drejta të arkëtueshme tatimore	27,326,723	114,587,546
Debitorë të tjerë	94,604,551	6,425,307
Total	5,392,765,702	3,663,842,966

12. MJETE MONETARE

12.1. Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Në monedhë vendase	46,189,350	21,232,560
Në valutë	9,085,716	39,634,293
Total	55,275,066	60,866,852

13. HUAMARRJE AFATGJATA

BRUNES SHPK*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

13.1. Huamarrjet afatgjata detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Huamarrje Afatgjata	0	0
Leasing	32,430,299	263,787
Total	32,430,299	263,787

13.2. Huamarrjet afatshkurtra detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Overdraft	57,356,801	57,356,801
Total	57,356,801	57,356,801

14. DETYRIME PËR QIRA FINANCIARE

14.1. Detyrimi për qiranë financiare është njohur në përputhje me kërkesat e SNFR 16. Qiraja financiare lidhet me qiranë e magazinës dhe dyqaneve dhe njëkohësisht selia qendrore e shoqërisë.

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Qira financiare afatgjatë	263,198,307	263,198,307
Total	263,198,307	263,198,307

15. LLOGARI TE PAGUESHME TREGTARE DHE LLOGARI TE TJERA TE PAGUESHME

15.1. Llogaritë e pagueshme tregtare detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Furnitorë	2,349,841,802	2,200,758,460
Parapagime te marra	3,014,658,734	2,238,087,335
Detyrime për Sigurimet Shoqërore	4,686,019	3,425,422
Te tjera detyrime	440,726,751	440,726,751
Detyrime Tatimore	10,352,296	7,486,186
Total	6,338,705,757	4,890,484,155

16. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

16.1. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	5,189,490,933	3,956,044,418
Total	5,189,490,933	3,956,044,418

17. TË ARDHURA TË TJERA

BRUNES SHPK*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

17.1. Të ardhurat e tjera nga shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	58,236,816	70,112,692
Total	58,236,816	70,112,692

18. LËNDA E PARË DHE MATERIALE TË KONSUMUESHME

18.1. Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Lënda e pare dhe materiale te konsumueshme	4,313,647,927	3,158,097,017
Total	4,313,647,927	3,158,097,017

19. SHPENZIME PERSONELI

19.1. Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Shpenzime personeli	193,374,595	170,017,489
Total	193,374,595	170,017,489

20. SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE NETO

20.1. Humbjet nga këmbimet valutore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Fitim neto nga këmbimet valutore	722,068	15,620,101
Shpenzime për interesa	6,429,534	14,823,159
Total	7,151,602	30,443,260

21. SHPENZIME TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT

21.1. Shpenzime e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Qira	92,208,964	12,325,981
Shpenzime marketingu	12,684,389	22,921,222
Të tjera shpenzime	41,874,073	17,499,126
Mirëmbajtje dhe riparime	(4,947,336)	14,347,483
Transport	18,804,974	14,132,793
Trajtime të përgjithshme	5,395,298	10,249,468
Taksa	8,051,307	4,238,582

BRUNES SHPK*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

Shpenzime për shërbimet bankare	5,770,530	6,753,936
Dieta	17,345,197	5,714,857
Sigurime	4,150,341	4,593,855
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	6,528,045	4,469,348
Gjoha dhe dëmshpërblime	20,862	3,846,554
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	3,891,915	3,923,931
Total	207,965,834	128,829,862

22. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

22.1. Përlllogaritja e shpenzimeve për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

Përshkrimi	31 Dhjetor, 2022	31 Dhjetor, 2021
Fitimi para tatimit	491,796,634	427,373,671
Shpenzimet e pazbritshme	30,481,759	7,630,929
Fitimi i tatueshëm	522,278,393	435,004,600
Norma e tatimit mbi fitimin	15%	15%
Tatimi mbi fitimin	78,341,759	65,250,690

23. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR**23.1. Shpjegim i përgjithshëm**

23.1.1. Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, dhe mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit. Menaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikëqyr menaxhimin e këtyre risqeve.

23.2. Risku i tregut

23.2.1. Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentet financiare të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

23.3. Risku i normave të interesit

23.3.1. Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

23.4. Risku i kredisë

23.4.1. Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumente të tjerë financiare. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

23.5. Risku i Likuiditetit

23.5.1. Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj lidhur me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditetit që janë specifike. Nëse Shoqëria do të duhet të ketë shumën të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria menaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

23.6. Risku i monedhës

23.6.1. Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit menaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve.

24. VLERA E DREJTË E INSTRUMENTAVE FINANCIARE

24.1. Instrumentet financiare përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare. Aktivet financiare përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbehet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumenteve.

25. BURIMET KRYESORE NË VLERËSIMIN E PASIGURISË

25.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

25.1.1. Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumën individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.

26. ANGAZHIME DHE PASIGURI

26.1. Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje, nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Përveç kësaj, më 31 dhjetor 2022 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.



BRUNES SHPK

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

27. NGJARJE PAS DATËS TË PASQYRAVE FINANCIARE

27.1. Asnjë ngjarje e rëndësishme e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

